



Projekti EPIC: Qytetaria Sipërmarrëse për Ndryshim Social

U prezantua Korniza e Re e Trajnimit: Një analizë e thelluar mbi Hartimin e Kurrikulave dhe Strategjinë e Zbatimit.

Kurrikula e sapo zhvilluar sjell një pikëpamje të plotë arsimore në sipërmarrjen sociale, e krijuar posaçërisht për të kultivuar një mendësi inovacioni social tek të rinjtë në Ballkanin Perëndimor. E strukturuar në gjashtë module kryesore, programi udhëzon pjesëmarrësit duke filluar nga trendet bazë të sipërmarrjes sociale dhe Kornizën EntreComp, deri te praktikat e modelimit të bizneseve sociale dhe identifikimit të mundësive. Për të garantuar një përvojë të plotë mësimore, përmbajtja ofrohet përmes një eCourse(kurs online) interaktiv dhe një PDF-je të shkarkueshme, e shoqëruar nga një seri testesh që ndihmojnë në përvetësimin e aftësive kryesore sipërmarrëse.

Përtej përmbajtjes kryesore mësimore, strategjia e zbatimit përfshin një Manual të specializuar i “Trajnimi të Trajnerëve”, i cili shërben si udhëzues i plotë për edukuesit për të zhvilluar kurrikulën në mënyrë efektive. Kjo mbështetet gjithashtu nga një set materialesh dhe burimesh shtesë që lidhin punën sociale me iniciativat sipërmarrëse. Duke ofruar këto mjete, iniciativa siguron që si trajnerët, ashtu edhe pjesëmarrësit, të jenë të pajisur me një “paketë mjetesh (toolkit)” për të menaxhuar inovacionin social, nga planifikimi fillestar deri te zbatimi i suksesshëm i modeleve të biznesit social.

Zbatimi i trajnimit në të gjithë Ballkanin Perëndimor tregoi angazhim të lartë. Në Kosovë, 83% e pjesëmarrësve ishin gra, dhe mbi 70% e të rinjve e konsideruan kurrikulën tërësisht të rëndësishme. Sesionet në



Shqipëri integruan sipërmarrje sociale lokale, me 92.9% të të rinjve që e vlerësuan realizimin e trajnimit me pikë të larta. Në Bosnje dhe Hercegovinë, një qasje e udhëhequr nga të rinjtë i ofroi shumë pjesëmarrësve eksperiencën e tyre të parë të strukturuar me konceptin e sipërmarrjes sociale.



Workshopet EPIC

Për më shumë informacion rreth projektit EPIC dhe për të qëndruar të përditësuar me aktivitetet tona, vizitoni faqen tonë të internetit epic-project.eu ose na kontaktoni në epic-project@kmop.org.



Funded by
the European Union

The European Commission's support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents, which reflect the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein. [Project Number: ERASMUS-YOUTH-2023-CB]